

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: MIRËMBAJTJE IMPIANTESH ELEKTRIKE PËR QENDRËN
SPITALORE UNIVERSITARE “NËNË TEREZA”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

50116100-2, 45259000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 14,769,981.87 (katërbëdhjetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një pikë tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të marrëveshjes kuadër.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr. 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, është vendosur me qëllim sigurimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, si dhe AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licensë profesionale të vleshme, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategorinë:

N.S- 14. A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV

Shënim: Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjisë/ministrisë kompetente, Republika e Shqipërisë. Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret e procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencën profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Duke vlerësuar që nëpërmjet **N.S- 14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni, TV, konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to,...**, Licenca dhe kategoria, e përcaktuar si kriter është në përputhje dhe lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës që do të prokurohet, fondin limit dhe cilësinë e shërbimit, që kërkohet të ofrohet nëpërmjet kësaj marrëveshje kuadër.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar stafin teknik, për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, sipas profileve të mëposhtme:

- a. 1 (një) inxhinier elektrik/ elektronik
- b. 1 (një) punonjës të kualifikuar si ekspert zjarrfikës, në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin
- c. 1 (një) punonjës teknik elektrik për sigurimin Teknik dhe sigurinë dhe shëndetin në punë.
- d. 1 (një) punonjës të licencuar apo certifikuar/kualifikuar për “Mirëmbajtje gjeneratorësh”.

Për punonjësin në pikën a, duhet të paraqitet:

- Diplomë përkatëse
- kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër

Për punonjësin në pikën b, c, d duhet të paraqitet:

- kontratë pune të vlefshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.
- dëshmi aftësie profesionale (të vlefshme), sipas Ligjit Nr.15/2017, “Mbi arsimin dhe formimin profesional”, i ndryshuar/ dokument licencimi/certifikimi/kualifikimi (të vlefshme)

Punonjësit e kërkuar në mënyrë të kombinuar mund të përmbushin një apo disa profile.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, hartuar nga AK.

Për shkak të natyrës teknike të objektit të prokurimit, të ndërhyrjeve që kërkojnë njohuri të avancuara mbi sistemet/implante elektrike, si dhe të nevojës për mbikëqyrje të përgjegjshme dhe të certifikuar, vlerësohet që operatori të ketë në stafin e tij të paktën një inxhinier elektrik/elektronik. Një inxhinier elektrik/elektronik siguron mbikëqyrjen profesionale të funksionimit të impianteve elektrike, merr përgjegjësi për korrektësinë teknike të ndërhyrjeve dhe garanton që çdo shërbim kryeht sipas standartave teknike dhe rregullave të sigurisë. Implantet elektrike objekt prokurimi përfshijnë sisteme të ndërlikuara (panele furnizimi, UPS, motogjeneratorë, etj) ku identifikimi i shkakut të defekteve kërkon njohuri të specializuara inxhinierike, të cilat nuk mund të mbulohen vetëm nga personel teknik i nivelit të mesëm.

Nisur nga natyra e objektit të prokurimit, si dhe duke marrë në konsideratë se defektet elektrike janë një nga shkaqet kryesore të zjarreve, eksperti zjarrfikës identifikon rreziqet potenciale në panele, kabllime, ngarkesa dhe pajisje elektrike, duke propozuar masa parandaluese për shmangien e zjarrit, duke siguruar që ndërhyrjet teknike të mos çenojnë kushtet e evakuimit, aksesin në pajisjet e fikjes dhe rrugët e emergjencës, në raste avarie apo zjarri eksperti zjarrfikës bashkërendon veprimet emergjente duke ndihmuar në minimizimin e pasajove për jetën.

Prania e një eksperti zjarrfikës garanton gjithashtu zbatimin e kërkesave ligjore dhe standarteve teknike për mbrojtjen nga zjarri, konkretisht Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

Punonjësi Teknik elektrik është i nevojshëm, pasi realizon kontrollin periodik të impianteve elektrike, mirëmbajtjen periodike të parashikuar në specifikime teknike, ndërhyrjet e menjëhershme në rast defekti apo varie. Tekniku elektrik zbaton procedurat e sigurisë gjatë kryerjes së shërbimeve objekt prokurimi në implantet elektrike, duke shmangur rreziqet për personelin, pacientët dhe pajisjet mjekësore, në përputhje me udhëzimet teknike dhe standartet e sigurisë.

Duke qenë se në shërbimin objekt prokurimi, përfshihet edhe mirëmbajtja e gjeneratorëve, vlerësohet e nevojshme që oferteusi të ketë në stafin e tij teknik edhe punonjës të licensuar apo certifikuar/kualifikuar për mirëmbajtjen e gjeneratorëve. Nisur nga fakti se gjeneratorët janë burimi kryesor i energjisë rezervë në spital, punonjësi i licensuar/certifikuar/kualifikuar për mirëmbajtje gjeneratorësh siguron që ata të jenë gjithmonë funksionalë, të gatshëm për aktivizim të menjëhershëm në rast ndërprerje të energjisë kryesore. Mirëmbajtja e gjeneratorëve kërkon njohuri specifike teknike dhe zbatim të procedurave të përcaktuara, të cilat mund të përmbushen nga ky punonjës, i cili garanton ndërhyrje të sakta teknike, shmangie të dëmtimeve të pajisjeve, ruajtje të garancive dhe jetëgjatësisë së gjeneratorëve. Ky punonjës shërben për kryerjen e testeve/kontrolleve periodike të përcaktuara në specifikimet teknike dhe vërtetifikon funksionimin korrekt të kalimit automatik në energji rezervë. Punonjësi i licensuar/certifikuar zbaton masat e sigurisë dhe standartet përkatëse, duke minimizuar rrezikun e aksidenteve apo zjarrit.

Ak ka përgjegjësi të sigurojë se shërbimi i mirëmbajtjes së Impjantave Elektrike do të bëhet nga punonjës të kualifikuar për të shmangur riskun për dëmtime, ndalime të shërbimit apo rrezikun për jetën dhe sigurinë e njerëzve.

AK ka përcaktuar që ofertuesi të disponojë stafin Teknik minimal të nevojshëm për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se është i pajisur me certifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë:

S SH EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

S SH EN ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

SSH EN ISO 14001 “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/të barazvlefshme;

Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Standarti ISO 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” – Ky standard është i nevojshëm pasi siguron që ofertuesi do të zbatojë procedura të strukturuar dhe të dokumentuara për realizimin e shërbimit, duke garantuar cilësi të qëndrueshme të shërbimit (mirëmbajtja, kontrolli, ndërhyrjet do të realizohen sipas standarteve teknike, pa devijime apo gabime). Implementimi i këtij standarti ndihmon në garantimin e transparencës dhe gjurmueshmërisë, optimizimin e burimeve dhe përmirësimin e eficiencës së shërbimeve.

Standarti ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” është vendosur si kriter me qëllim që AK të sigurohet që ofertuesi kryen shërbimin në përputhje me standartet e kërkuara sa i takon shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe me qëllim parandalimin/shmangien e çfarëdo rreziku, pasi shërbimet që do të kryhen përfshijnë ndërhyrje në impiante elektrike, me rrezik të lartë. Pajisja e ofertuesit me këtë standart garanton AK se operatori ekonomik ka një sistem të dokumentuar për identifikimin e rreziqeve, marrjen e masave parandaluese, trajnimin e punonjësve për sigurinë, duke garantuar gjithashtu se gjatë kryerjes së shërbimeve objekt prokurimi zbatohen masat për të mbrojtur punonjësit teknikë gjatë ndërhyrjeve.

SSH EN ISO 14001 “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/të barazvlefshme; Ky standard është i nevojshëm duke marrë në konsideratë se shërbimi I mirëmbajtjes së impianteve elektrike dhe gjeneratorëve në spital ka ndikim të drejtëpërdrejtë mjedisor dhe kërkon menaxhim të kontrolluar të këtij ndikimi. Gjeneratorët në vetvete prodhojnë emetime në ajër, zhurmë, mbetje të rrezikshme (vajra, filtra, karburant I ndotur) dhe si rrjedhojë ISO 14001 garanton që ofertuesi ka procedura të miratuara për identifikimin, kontrollin dhe reduktimin e këtyre ndikimeve, në përputhje me legjislacionin mjedisor. Duke vlerësuar se spitalet janë institucione me ndikim të lartë social, ku cdo ndotje ndikon drejtëpërdrejtë pacientët, stafin dhe komunitetin përreth, ISO 14001 garanton përgjegjësi mjedisore të strukturuar.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër realizimin e shërbimit objekt prokurimi sipas kushteve të kërkuara në specifikime teknike.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të

parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojnë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Duke qenë se specifikimet teknike përshkruajnë standartet, parametrat dhe kërkesat operationale që duhet të respekton gjatë realizimit të shërbimit, deklarata obligon ofertuesin të angazhohet që çdo ndërhyrje, mirëmbajtje apo testim/kontroll të kryhet sipas këtyre kërkesave, duke garantuar që shërbimi nuk do të devijojë nga standarti i kërkuar.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, përlllogaritja e fondit limit janë përcjellë pranë OBP, të hartuara nga grupi i punës i caktuara nga titullari i autoritetit kontraktor “Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Në relacionin e hartuara nga grupi i punës, rezulton se:

specifikimet teknike në lidhje me kërkesat për mirëmbajtjen e pajisjeve/sistemeve elektrike funksionale, të ndodhura në çdo godinë teknike apo spitalore janë hartuar pas përditësimit të listës së inventarit të këtyre sistemev/pajisjeve, mbi të cilat është mbështetur parashikimi i zërave dhe sasive të shërbimeve të riparimit mirëmbajtjes.

Specifikimet teknike si dhe Preventivi me zërat dhe sasitë respektive të parashikuara për riparim- rembatje, mbështeten në:

- 1. Marrëveshjen kuadër të kaluar për sistemet ekzistuese dhe eksperiencën ndër vite për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e këtyre sistemeve;*
- 2. Manualët teknike të prodhuesit të çdo sistemi/pajisje, për sistemet e godinave të rikonstruktura, ku përcaktohen shërbimet e nevojshme të mirëmbajtjes periodike si dhe kushtet e ndërrimit të pjesëve në bazë të orëve të shfrytëzimit, për të garantuar efikasitetin dhe siguri të pajisjes;*
- 3. Vitin e vënies në punë të cdo sistemi/pajisje, historikun e mirëmbajtjes dhe defekteve të shfaqura gjatë viteve, gjendjen teknike aktuale, pjesët e konsumuara/dëmtuara si dhe problematikat e konstatuara;*
- 4. Normativat, standartet kombëtare dhe ndërkombëtare (europiane) si dhe kërkesat teknike që përcaktojnë kriteret për të garantuar sigurinë, efikasitetin dhe besueshmërinë e sistemit elektrik në tërësi dhe çdo pajisje në veçanti, me vëmendje të veçantë në mjediset kritike siç janë spitalet.*

Një spital i rëndësishëm së veçantë si QSUT, e ka të domosdoshme dhe jetike që të sigurojë furnizim me energji të pandërprerë, pasi është thelbësore për funksionimin

- Pajisjeve shpëtimtare të jetës, siç janë ventilatorët, monitorët dhe pajisjet kirurgjikale. - Departamenteve kritike, siç janë sallat e operacionit, njësitë e kujdesit intensi jesisitë e EKRETA emergjencës dhe laboratorët.

- Sistemeve të sigurisë, siç janë alarmet e zjarrit, ashensorët dhe ndriçimi i emergjencës. - Garantimin e jetës së pacientëve, pasi një ndërprerje e energjisë mund të rrezikojë jetën e pacientëve, duke kompromentuar operacionet mjekësore dhe duke shkaktuar ndërprerje serioze.

Për këtë arsye është shumë e rëndësishme që sistemi i furnizimit me energji elektrike. motogjeneratorëve dhe UPS, të mirëmbahen rregullisht, të testohen dhe të kontrollohen periodikisht për defekte, sipas normativave dhe standarteve kombëtare/ndërkombëtare të sigurisë së sistemit elektrik, në mënyrë që të jenë në gjendje optimale teknike dhe të kenë aftësinë për t'u aktivizuar menjëherë edhe në kushte të jashtëzakonshme emergjence (ndërprerje energjie nga rrjeti i shpërndarjes).

Mbi këto parime ligjore dhe teknike është punuar për argumentimin e nevojave dhe përllogaritjen e fondit limit për këtë procedurë prokurimi.

NJËSIA E PROKURIMIT